



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 49

9 maj

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Vendim i KM nr. 225, datë 28.3.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 180, datë 31.3.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën e Kozarës të qarkut të Beratit”, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Kozarë, të qarkut të Beratit”.....	2555
Vendim i KM nr. 232, datë 4.4.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për financimin e shoqatës “Vatra”, me seli në SHBA, me rastin e festimit të 100-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe kremtimit të 100-vjetorit të krijimit të shoqatës.....	2556
Vendim i KM nr. 233, datë 4.4.2012	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.	2556
Vendim i KM nr. 235, datë 4.4.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1020, datë 14.10.2009 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Europian”, të ndryshuar.....	2564
Vendim i KM nr. 236, datë 4.4.2012	Për kalimin e titullit të pronësisë së sipërfaqes prej 450 m ² , të ndodhur në zonën kadastrale 2735, me nr. 29/21, fshati Mullet, komuna Petrelë, Tiranë, që do të tjetërsohet në favor të subjektit kërkues “Mane TCI” sh.p.k., për llogari të fondit të kompensimit financiar.....	2564
Vendim i KM nr. 237, datë 4.4.2012	Për kalimin e titullit të pronësisë së sipërfaqes prej 400 m ² , të ndodhur në zonën kadastrale 2735, me nr. 29/20, fshati Mullet, komuna Petrelë, Tiranë, që do të tjetërsohet në favor të subjektit kërkues “Mane TCI” sh.p.k., për llogari të fondit të kompensimit financiar.....	2565

Vendim i KM nr. 238, datë 4.4.2012	Për kalimin e titullit të pronësisë së sipërfaqes prej 870 m ² , të ndodhur në zonën kadastrale 2735, me nr. 29/10, fshati Mullet, komuna Petrelë, Tiranë, që do të tjetërsohet në favor të subjektit kërkues “Mane TCI” sh.p.k., për llogari të fondit të kompensimit financiar.....	2566
Vendim i KM nr. 239, datë 4.4.2012	Për kalimin e titullit të pronësisë së sipërfaqes prej 940 m ² , të ndodhur në zonën kadastrale 2735, me nr. 29/19, fshati Mullet, komuna Petrelë, Tiranë, që do të tjetërsohet në favor të subjektit kërkues “Mane TCI” sh.p.k., për llogari të fondit të kompensimit financiar.....	2567
Vendim i KM nr. 240, datë 4.4.2012	Për kalimin e titullit të pronësisë së sipërfaqes prej 375 m ² , të ndodhur në zonën kadastrale 2735, me nr. 29/22, fshati Mullet, komuna Petrelë, Tiranë, që do të tjetërsohet në favor të subjektit kërkues “Mane TCI” sh.p.k., për llogari të fondit të kompensimit financiar.....	2568
Vendim i KM nr. 241, datë 28.3.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 1566, datë 26.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave paluajtshme shtetërore në komunën Katund i Ri, të qarkut të Durrësit”, dhe për një shtesë në vendimin nr. 697, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Katund i Ri, të qarkut të Durrësit”.....	2569
Vendim i KM nr. 243, datë 4.4.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 431, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit”.....	2569
Vendim i KM nr. 244, datë 4.4.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Buçimas, të qarkut të Korçës.....	2570
Urdhër i MPPT nr. 35, datë 23.3.2012	Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të ekuipazhit fluturues, organizatave të trajnimit dhe seksioneve aeromjekësore AMC dhe AME.....	2571
Urdhër i MD nr. 83/1, datë 6.3.2012	Për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit.....	2579
Vendim i GJK nr.22, datë 23.4.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.174, datë 11.7.2008, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe i vendimit nr.00-2010-666 (515), datë 21.5.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi)..	2580
Vendim i GJK nr.23, datë 23.4.2012	Me objekt interpretimin e vendimit nr.4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me kërkues Leonard Luzi.	2584
Kërkesë e METE nr. 2153/5 datë 18.4.2012	Për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit: tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore” që preken nga ndërtimi i linjës 110 kv Tirana 2-nënstacioni 110 kv Kashar-Selitë.....	2587

VENDIM
Nr. 225, datë 28.3.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 180, DATË 31.3.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË KOMUNËN E KOZARËS TË QARKUT TË
BERATIT”, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 326, DATË 19.3.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË
PYJEVE DHE KULLOTAVE QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË
QEVERISJES VENDORE, KOMUNA KOZARË, TË QARKUT TË BERATIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një pakësimi në listën e inventarit të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Kozarë. Lista është me 1 (një) fletë dhe mbaron me numër rendor 2.

2. Miratimin e listës shtesë të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Kozarë. Lista është me 1 (një) fletë dhe mbaron me numër rendor 10.

3. Miratimin e një pakësimi në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të komunës Kozarë. Lista është me 1 (një) fletë dhe mbaron me numër rendor 1.

4. Miratimin e listës shtesë përfundimtare të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të komunës Kozarë. Lista është me 2 (dy) fletë dhe mbaron me numër rendor 49.

5. Ndryshimet në listën e inventarit dhe në listën përfundimtare të pyjeve dhe kullotave, që transferohen në pronësi, si dhe lidhja 1 (një) i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

6. Ngarkohet Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kozarë, e qarkut të Beratit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore Kozarë, qarku Berat

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
595-621; 629-630; 633	Sipërfaqe pyjore, djerrë, kullosore etj.	Pronësi
641-649; 708-717		



VENDIM
Nr. 232, datë 4.4.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E PUNËVE TË JASHTME, PËR FINANCIMIN E SHOQATËS “VATRA”, ME SELI NË
SHBA, ME RASTIN E FESTIMIT TË 100-VJETORIT TË PAVARËSISË SË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, SI DHE KREMTIMIT TË 100-VJETORIT TË KRIJIMIT TË SHOQATËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, t’i shtohet fondi i përgjithshëm prej 3 640 000 (tre milionë e gjashtëqind e dyzet mijë) lekësh, për financimin e shoqatës “Vatra”, me seli në SHBA, me rastin e festimit të 100-Vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe kremtimit të 100-vjetorit të krijimit të shoqatës.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 233, datë 4.4.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT,
PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT MBI NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INVESTIMEVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Azerbajxhanit, që këtu quhen “palët kontraktuese”,

me dëshirën për të intensifikuar bashkëpunimin e tyre ekonomik për përfitim reciprok të të dy vendeve;

me synim krijimin dhe ruajtjen e kushteve të përshtatshme dhe të drejtave për investimet e investitorëve të një pale kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese; dhe

të vetëdijshëm se nxitja dhe mbrojtja reciproke e investimeve sipas kësaj marrëveshjeje do të stimulojë iniciativat e biznesit në këtë fushë;

me dëshirën për të arritur këta objektiva në përputhje me mbrojtjen e shëndetit, sigurinë e mjedisit dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

1. Termi “investime” do të thotë të gjitha llojet e sendeve pasurore të krijuara ose përfituara drejtpërdrejt nga investitorët e një pale kontraktuese plotësisht ose pjesërisht në territorin e palës tjetër kontraktuese, në pajtim me legjislacionin e kësaj pale kontraktuese dhe veçanërisht, megjithëse jo përjashtimisht, përfshin:

a) pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe çdo të drejtë tjetër pasurore, si: hipotekat, e drejta e pengut, qiratë, pengjet, uzufuktin ose të drejta reale të ngjashme;

b) një shoqëri, aksionet, pjesët dhe çdo formë tjetër e pjesëmarrjes në një shoqëri;

c) paratë, pretendimet në para ose e drejta për një veprim sipas një kontrate që ka vlerë ekonomike dhe në lidhje me një investim;

d) të drejtat e pronësisë intelektuale (e drejta e autorit, të drejtat përkatëse, të drejtat për topografitë e integruara të qarqeve të integruara dhe bazat e të dhënave) dhe të drejtat e pronësisë industriale (të drejtat për shpikjet, modelet e përdorimit, modelet industriale, markat tregtare dhe treguesit geografikë), proceset teknike, ekspertiza dhe vullneti i mirë;

e) të drejtat për të ndërmarrë aktivitete ekonomike dhe tregtare që caktohen me ligj ose në bazë të një kontrate, duke përfshirë koncesionet për kërkimin, kultivimin, nxjerrjen ose shfrytëzimin e burimeve natyrore.

2. Termi “investitor” do të thotë:

a) çdo person fizik që ka shtetësinë e një pale kontraktuese në pajtim me ligjet e shtetit;

b) një shoqëri ose një person tjetër juridik i themeluar ose i krijuar rregullisht në pajtim me ligjet e zbatueshme të shtetit të një pale kontraktuese dhe që ka selinë e tij dhe që zhvillon aktivitete kryesore biznesi brenda territorit të shtetit të asaj pale kontraktuese, i cili bën një investim në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese në pajtim me legjislacionin e kësaj pale kontraktuese.

Nëse investitori është në pronësi ose kontrollon nga personat që kanë shtetësinë e një shteti që nuk ka marrëdhënie diplomatike me palën kontraktuese në territorin e së cilës bëhet investimi, ky investitor nuk përfiton nga kjo marrëveshje.

Çdo ndryshim në formën në të cilën investohen ose riinvestohen sendet pasurore nuk ndikon në karakterin e tyre si investime.

3. Termi “të ardhurat” janë shumat e dhëna nga investimet dhe veçanërisht, megjithëse



jopërrjashtimisht, përfshin fitimet, interesin, fitimet e kapitalit, dividendët dhe tarifatat e licencave dhe tarifatat ose çdo pagesë në natyrë në lidhje me një investim.

4. Termi “territor” është:

a) në lidhje me Republikën e Shqipërisë nënkupton territorin nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territorial, si dhe zonën detare dhe shelfin kontinental mbi të cilat Republika e Shqipërisë, në pajtim me ligjet e saj të brendshme dhe të drejtën ndërkombëtare, ushtron të drejtat e saj sovraane dhe të ligjshme;

b) në lidhje me Republikën e Azerbajxhanit, territori i Republikës së Azerbajxhanit, duke përfshirë sektorin e detit Kaspik mbi të cilin Republika e Azerbajxhanit, në pajtim me legjislacionin e brendshëm dhe të drejtën ndërkombëtare, ushtron të drejtat sovraane ose juridiksionin.

Neni 2

Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

1. Secila palë kontraktuese inkurajon dhe krijon kushte të favorshme në territorin shtetëror të saj për investitorët e palës tjetër kontraktuese për të bërë investime në territorin e shtetit dhe i pranon këto investime në pajtim me legjislacionin e saj të brendshëm.

2. Secila palë kontraktuese, brenda kuadrit të saj legjislativ, shqyrton në mirëbesim të gjitha kërkesat për lejet e nevojshme në lidhje me investimet në territorin e shtetit të saj, duke përfshirë autorizimet për angazhimin e punonjësve zbatues, menaxherëve, specialistëve dhe personelit teknik sipas zgjedhjes së investitorit.

3. Investimeve të bëra nga investitorët e një pale kontraktuese në territorin shtetëror të palës tjetër kontraktuese në pajtim me legjislacionin e saj për trajtimin e të huajve të kësaj pale kontraktuese, u jepet gjithmonë një trajtim i drejtë dhe i përshtatshëm dhe gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë.

4. Asnjë palë kontraktuese nuk cenon me masa të paarsyeshme, arbitrare dhe diskriminuese operimin, menaxhimin, ruajtjen, përdorimin, gëzimin, zgjerimin, përfitimin ose disponimin e këtyre investimeve.

5. Asnjë palë kontraktuese nuk vendos masa detyruese për investimet e investitorëve të palës tjetër kontraktuese në lidhje me blerjen e materialeve, mjeteve të prodhimit, operimin, transportin, tregtimin e produkteve të tyre ose urdhrave të ngjashëm që kanë efekte të paarsyeshme ose diskriminuese.

Neni 3

Marrja e informacionit për investitorin dhe transparenca

1. Pala kontraktuese pritëse ka të drejtën të kërkojë informacion nga nja investitor i mundshëm ose shteti dërgues në lidhje me menaxhimin e biznesit dhe praktikën e tij si investitor, duke përfshirë në shtetin dërgues. Pala kontraktuese pritëse mbron informacionin konfidencial për biznesin që merr në lidhje me këtë. Pala kontraktuese pritëse e bën informacionin e dhënë publik në komunitetin ku mund të vendoset investimi, duke respektuar ruajtjen e informacioni konfidencial të biznesit dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm të brendshëm.

2. Secila palë siguron që, në masën e mundur, ligjet, rregulloret, procedurat dhe aktet administrative të saj, si dhe vendimet gjyqësore me zbatim të përgjithshëm dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku ajo është palë, pas hyrjes së tyre në fuqi, të cilat mund të prekin investimet e investitorëve të palës tjetër në territorin e saj shtetëror, të publikohen menjëherë ose të bëhen publike në një mënyrë tjetër.

Neni 4

Trajtimi kombëtar dhe trajtimi i kombit më të favorizuar

1. Pasi një palë kontraktuese pranon një investim në territorin e saj shtetëror në pajtim me legjislacionin e saj të brendshëm, ajo u jep investimeve të investitorëve të palës tjetër kontraktuese një trajtim më pak të favorshëm sesa ai që u jep, në rrethana të ngjashme, investimeve të investitorëve të vet ose investimeve të investitorëve të një shteti të tretë, cilido që të jetë më i favorshëm për investitorin përkatës.

2. Secila palë kontraktuese në territorin e vet u jep investitorëve të palës tjetër kontraktuese, në lidhje me menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin ose disponimin e investimeve të tyre, një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u jep në rrethana të ngjashme investitorëve të vet ose investitorëve të një shteti të tretë, cilido që të jetë më i favorshëm për investitorin përkatës.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk interpretohen sikur detyrojnë palën kontraktuese t'u japë investitorëve të palës tjetër kontraktuese përfitimet e një trajtimi, preference ose privilegji që rrjedh nga:

a) anëtarësimi në një zonë tregtare ekzistuese ose të ardhshme, treg i përbashkët, bashkim doganor, bashkim ekonomik, bashkim monetar ose një organizatë tjetër ekonomike rajonale; dhe

b) një marrëveshje ose masë ndërkombëtare në lidhje me, tërësisht ose pjesërisht, tatimin;

c) një konventë ose traktat shumëpalësh në lidhje me investimet, në të cilën një palë kontraktuese është ose mund të behet palë.

4. Trajtimi i përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni jepet mbi bazën e reciprocitetit.

Neni 5

Shpronësimi

1. Investimet e investitorëve të një pale kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese nuk shtetëzohen, shpronësohen ose i nënshtrohen ndryshe një mase tjetër që, drejtpërdrejt ose jo, ka efektin e shtetëzimit ose shpronësimit (këtu quhet "shpronësim"), përveçse për qëllime publike dhe sipas një procesi të rregullt, mbi një bazë jodiskriminuese dhe kundrejt pagesës së një kompensimi të menjëhershëm, të përshtatshëm dhe të efektshëm.

2. Ky kompensim është i barabartë me vlerën e tregut të investimit të shpronësuar menjëherë para se të kryhet shpronësimi apo të jetë bërë i njohur publikisht, cilido të jetë më parë.

3. Kjo vlerë e tregut llogaritet në një monedhë lirisht të këmbyeshme mbi bazën e normës së këmbimit të tregut që zbatohet për atë monedhë në datën e transfertës. Kompensimi përfshin gjithashtu interesin sipas normës tregtare të vendosur me bazë tregu për monedhën në fjalë nga data e shpronësimit deri në datën e pagesës. Kompensimi paguhet pa vonesë, është efektivisht i realizueshëm dhe lirisht i transferueshëm.

4. Investitori i interesuar ka të drejtën e rishikimit të menjëhershëm nga një autoritet gjyqësor ose një autoritet tjetër kompetent dhe i pavarur i palës kontraktuese të çështjes së tij, duke përfshirë vlerësimin e investimeve të tij dhe pagesën e kompensimit në pajtim me parimet e përcaktuara në këtë nen.

Neni 6

Kompensimi për humbjet

1. Investitorët e një pale kontraktuese, investimet e të cilëve në territorin e palës tjetër kontraktuese pësojnë humbje për shkak të luftës ose konfliktit të armatosur, gjendjes së emergjencës kombëtare, revoltës, kryengritjes, trazirave publike, fatkeqësive natyrore ose ngjarjeve të tjera të ngjashme, marrin nga pala kontraktuese e fundit në lidhje me rikthimin, zhdëmtimin, kompensimin



ose formave të tjera të shlyerjes, zgjidhje tjetër jo më pak të favorshme se ajo që kjo palë kontraktuese u jep investitorëve të vet ose investitorëve të një shteti të tretë, cilado të jetë më e favorshme për investitorin përkatës. Pagesat përkatëse janë efektivisht të realizueshme, lirisht të konvertueshme dhe menjëherë të transferueshme.

2. Pa cenuar paragrafin (1) të këtij neni, një investitor i një pale kontraktuese i cili në një nga situatat e përmendura në këtë paragraf, pëson humbje në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese, që rrjedhin nga:

- marrja në zotërim e investimit të tij ose i një pjese të tyre nga forcat e armatosura ose autoritetet e këtij të fundit; ose
- shkatërrimi i investimeve të tij ose i një pjese të tyre nga forcat e armatosura ose autoritetet e këtij të fundit, të cilat nuk kanë qenë të domosdoshme për situatën, merr një kompensim të përshtatshëm duke pasur parasysh rrethana të veçanta.

Neni 7

Transfertat e lira

1. Në pajtim me legjislacionin e saj, secila palë kontraktuese u siguron në mirëbesim investitorëve të palës tjetër kontraktuese transfertën e lirë të pagesave në lidhje me investimet e tyre në dhe nga territori i shtetit. Këto transfertat përfshijnë veçanërisht, megjithëse jo përjashtimisht:

- a) shumat principale dhe shtesë për mirëmbajtjen, zhvillimi ose rrjetin e investimit;
- b) të ardhurat neto, fitimet kapitale, dividendët, interesin, tarifat e licencave, tarifat dhe çdo e ardhur faktike që rrjedh nga investimet;
- c) të ardhurat nga investimet, sipas përkufizimit në nenin 1;
- d) pagesat në lidhje me kontratat, duke përfshirë marrëveshjet e huave;
- e) kompensimet e parashikuara sipas neneve 5 dhe 6;
- f) shumat nga shitja e plotë ose e pjesshme, ose likuidimi i një investimi;
- g) pagat dhe shpërblimet e tjera për personelin e punësuar të ardhur nga jashtë shtetit në lidhje me investimin;
- h) pagesat në lidhje me tarifat e menaxhimit;
- i) pagesat që rrjedhin nga zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

2. Të gjitha transfertat sipas kësaj marrëveshjeje bëhen pa kufizim dhe vonesa të panevojshme në një monedhë lirisht të konvertueshme, me kursin e këmbimit që zbatohet në datën e transfertës për monedhën e transfertës. Nëse norma e tregut është e padisponueshme, kursi i këmbimit do të jetë kursi më i fundit i këmbimit i përdorur në monedhat e SDR.

3. Pavarësisht paragrafëve 1 dhe 2 më sipër, një palë kontraktuese mund të pengojë ose vonojë një transfertë nëpërmjet zbatimit të drejtë, jodiskriminues dhe me mirëbesim të masave që sigurojnë respektimin nga investitori të legjislacionit të palës kontraktuese pritëse, në lidhje me:

- a) pagesën e tatimeve dhe detyrimeve;
- b) falimentimin, paaftësinë paguese ose mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve;
- c) veprat penale; dhe
- d) sigurimin e respektimit të urdhrave ose vendimeve të gjykatave ose autoriteteve gjyqësore të palës kontraktuese pritëse.

Neni 8

Kushtet më të favorshme

Nëse legjislacioni i palës tjetër kontraktuese ose detyrimet sipas së drejtës ndërkombëtare që ekzistojnë aktualisht ose që vendosen më vonë ndërmjet palëve kontraktuese si shtesë ndaj kësaj

marrëveshjeje përmbajnë një rregullim, të përgjithshëm ose specifik, që u japin të drejtë investimeve të investitorëve të palës tjetër kontraktuese për një trajtim më të favorshëm se ai i parashikuar në këtë marrëveshje, ky rregullim, në masën që është më i favorshëm, ka përparësi mbi këtë marrëveshje.

Neni 9

Transferimi i të drejtave

Nëse një palë kontraktuese ose një agjenci e caktuar prej saj (këtu quhet “sigurues”) bën një pagesë në bazë të një garancie që ka dhënë ndaj risqeve jotregtare në lidhje me investimet në territorin e palës tjetër kontraktuese, kjo palë kontraktuese pritëse njeh kalimin të garantuesit të të gjitha të drejtave dhe pretendimeve që rrjedhin nga ky investim dhe njeh që garantuesi të ketë të drejtë të ushtrojë këto të drejta dhe të realizojë pretendimet në të njëjtën masë, si edhe investitori i parë.

Neni 10

Konsultimet

Palët kontraktuese bien dakord të konsultohen menjëherë, me kërkesë të njërit, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin ndërmjet tyre në lidhje me këtë marrëveshje ose të rishikojnë çdo çështje mbi zbatimin e kësaj marrëveshjeje ose të shqyrtojnë çdo çështje që mund të rrjedhë nga kjo marrëveshje. Këto konsultime zhvillohen ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese në një vend dhe kohë që bihet dakord ndërmjet palëve kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 11

Refuzimi i përfitimeve

1. Një palë kontraktuese mund të refuzojë përfitimet sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë të drejtën për të filluar ose vazhduar procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, për një investitor të palës tjetër kontraktuese dhe investimet e atij investitori, nëse:

- investitori është në pronësi ose kontrollon nga personat që kanë shtetësinë e një shteti që nuk është palë kontraktuese ose e palës refuzuese; ose
- investitori nuk zhvillon aktivitete kryesore biznesi në territorin shtetëror të palës tjetër kontraktuese.

2. Për mënjanimin e dyshimit, nëse ushtrohet, ky refuzim mund të zbatohet për të gjithë ose një pjesë të specifikuar të investitorëve ose investimeve të investitorëve, qoftë investitorë ose investime ekzistuese ose të ardhshme.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve kontraktuese

1. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, nëse është e mundur, zgjidhen nëpërmjet bisedimeve.

2. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet në këtë mënyrë brenda gjashtë muajve nga fillimi i bisedimeve, me kërkesë të një palë kontraktuese, i paraqitet Gjykatës së Arbitrazhit në pajtim me dispozitat e këtij neni.

3. Gjykata e Arbitrazhit ka këtë përbërje: brenda dy muajve nga marrja e kërkesës për arbitrazh, secila palë kontraktuese emëron një anëtar të Gjykatës dhe këta dy anëtarë zgjedhin një



shtetas të një shteti të tretë si kryetar me aprovimin e të dyja palëve kontraktuese. Kryetari caktohet brenda katër muajve nga data e emërimit të dy anëtarëve të tjerë.

4. Nëse brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni nuk janë bërë emërimet e nevojshme, secila palë kontraktuese, nëse nuk është rënë dakord ndryshe, mund të ftojë kryetarin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të bërë emërimet e nevojshme. Nëse kryetari është shtetas i një pale kontraktuese ose nëse pengohet në përmbushjen e këtij funksioni, zëvendëskryetari ftohet për të bërë emërimet e nevojshme. Nëse zëvendëskryetari është shtetas i një pale kontraktuese ose pengohet në ushtrimin e këtij funksioni, anëtari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë pas tij në detyrë, i cili nuk është shtetas i një pale kontraktuese, ftohet të bëjë emërimet e nevojshme.

5. Gjykata e Arbitrazhit vendos rregullat e veta të procedurës. Gjykata e Arbitrazhit i merr vendimet e saj mbi bazën e dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe rregullave dhe të drejtës ndërkombëtare të zbatueshme ndërmjet palëve kontraktuese. Gjykata e Arbitrazhit i merr vendimet e saj me shumicë votash. Këto vendime janë përfundimtare dhe detyruese për të dyja palët kontraktuese. Secila palë kontraktuese mbulon shpenzimet e arbitrit të emëruar prej saj dhe përfaqësimin në gjykimin në arbitrazh. Shpenzimet e kryetarit dhe shpenzimet e tjera mbulohen në pjesë të barabarta nga të dyja palët kontraktuese.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për investimet ndërmjet një pale kontraktuese dhe një investitori të palës tjetër kontraktuese

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet një pale kontraktuese dhe një investitori të palës tjetër kontraktuese, nëse është e mundur, zgjidhet me pajtim nëpërmjet bisedimeve ndërmjet palëve në mosmarrëveshje. Para se një investitor të paraqesë një mosmarrëveshje në arbitrazh sipas këtij neni, palët në mosmarrëveshje zhvillojnë bisedime në mirëbesim. Vendi i bisedimeve është kryeqyteti i palës kontraktuese në mosmarrëveshje, përveç kur palët në mosmarrëveshje vendosin ndryshe. E drejta e një investitori për të paraqitur një mosmarrëveshje sipas procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në nënparagrafin 2 të këtij neni nuk cenohet apo refuzohet thjesht nëpërmjet refuzimit të palës kontraktuese në mosmarrëveshje për të marrë pjesë në bisedime.

2. Mjetet ligjore lokale sipas legjislacionit të brendshëm të një pale kontraktuese në territorin shtetëror të së cilës është bërë investimi, janë të disponueshme për investitorët e palës tjetër kontraktuese mbi bazën e trajtimit jo më pak të favorshëm se ai që u jepet investimeve të investitorëve të vet ose investitorëve të një shteti të tretë, cilido që të jetë më i favorshëm për investitorët.

3. Nëse një mosmarrëveshje e tillë nuk mund të zgjidhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga data në të cilën mosmarrëveshja është njoftuar nga njëra palë, ajo i paraqitet, me kërkesë dhe sipas zgjedhjes së investitorit të palës kontraktuese:

a) një gjykate vendore kompetente të palës kontraktuese në territorin e së cilës është bërë investimi;

b) Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve nga Investimet (ICSID) të themeluar në Konventën e Uashingtonit të datës 18 mars 1965, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera, nëse të dyja palët janë bërë palë në këtë konventë.

c) një gjykatë ndërkombëtare arbitrazhi *ad hoc* të themeluar në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të drejtën ndërkombëtare tregtare (UNICITRAL);

4. Një investitor që ka paraqitur një pretendim në lidhje me sjelljen ose masën e palës kontraktuese që pretendohet të ketë shkaktuar mosmarrëveshjen te gjykata kompetente e shtetit të

palës kontraktuese ose në një procedurë të rënë paraprakisht dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, nuk ka të drejtë ta paraqesë mosmarrëveshjen në arbitrazh ndërkombëtar, siç parashikohet në paragrafin 3 të këtij neni.

5. Asnjëra prej palëve kontraktuese që është palë në një mosmarrëveshje nuk mund të ngrejë kundërshtim në ndonjë fazë të gjykimit në arbitrazh ose të ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, për shkak të faktit se investitori që është pala kundërshtarë në mosmarrëveshje, ka marrë një zhdëmtim që mbulon plotësisht ose pjesërisht humbjet në bazë të një kontrate sigurimi.

6. Mosmarrëveshja zgjidhet në pajtim me ligjin, duke zbatuar kushtet e kësaj marrëveshjeje, ligjin e shtetit të palës kontraktuese në mosmarrëveshje dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare publike.

7. Ky vendim është përfundimtar dhe detyrues për palët në mosmarrëveshje dhe zbatohet sipas legjislacionit të brendshëm.

Neni 14

Zbatimi i marrëveshjes

Dispozitat e kësaj marrëveshjeje zbatohen për investimet e bëra nga investitorët e një prej palëve kontraktuese para dhe pas datës së hyrjes së saj në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe është e zbatueshme nga data e hyrjes së saj në fuqi, por nuk zbatohet për mosmarrëveshjet në lidhje me një investim ose pretendim që është zgjidhur para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 15

Shtesat dhe ndryshimet

Çdo shtesë dhe ndryshim mund t'i bëhet kësaj marrëveshjeje me pëlqimin reciprok të palëve kontraktuese. Këto shtesa dhe ndryshime bëhen në formën e protokolleve të veçanta që kanë qenë pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje dhe hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitat e nenit 16 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 16

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe prishja

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilës palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme për hyrjen në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe dhe mbetet në fuqi deri në fund të periudhës dymbëdhjetëmujore pas datës së dërgimit të njoftimit me shkrim të një prej palëve kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi synimin për prishjen e kësaj marrëveshjeje.

3. Në lidhje me investimet e bëra para datës së prishjes së kësaj marrëveshjeje, dispozitat e neneve 1 deri 15 do të vazhdojnë të jenë në fuqi për një periudhë prej dhjetë vjetësh nga data e njoftimit në lidhje me prishjen e saj, përveç kur bihet dakord ndryshe nga palët kontraktuese.

Bërë në Baku, më 9 shkurt 2012, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, azerbajxhanase dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllor autentike. Në rastin e ndryshimit në interpretim dhe zbatim, ka përparësi teksti në gjuhën angleze.



VENDIM
Nr. 235, datë 4.4.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1020, DATË 14.10.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË
ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EUROPIAN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 9000 datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të neneve 6 e 8 të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian, për rregullat e bashkëpunimit të asistencës për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 6 të vendimit nr. 1020, datë 14.10.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“ç) Këshilli i menaxhimit ka si funksione miratimin e programeve të punës vjetore e strategjike, të raporteve vjetore e të pasqyrave financiare dhe monitorimin e funksionimit të agjencisë.

d) Mënyra e organizimit të brendshëm, autoriteti, mënyra e vendimmarrjes së strukturave të agjencisë, si dhe çështje të tjera përcaktohen në rregulloren e funksionimit të agjencisë, e cila miratohet nga këshilli i menaxhimit, me propozim të drejtorit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 236, datë 4.4.2012

**PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQES PREJ 450 M², TË
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2735, ME NR. 29/21, FSHATI MULLET,
KOMUNA PETRELË, TIRANË, QË DO TË TJETËRSOHEM NË FAVOR TË SUBJEKTIT
KËRKUES “MANE TCI” SHPK, PËR LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT
FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar dhe të pikës 4 të vendimit nr. 12, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e të drejtës së pronësisë të pasurisë së paluajtshme me nr. 29/21, në zonën kadastrale 2735, fshati Mullet, komuna Petrelë, Tiranë, me indeks harte K-34-100 (45-C), me sipërfaqe 450 (katërqind e pesëdhjetë) m², të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në favor të subjektit kërkues “Mane TCI” sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqes që tjetërsohet, të përlllogaritet sipas vendimit nr. 139, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, duke pasur parasysh edhe vlerën e kaparit, të paguar nga subjekti kërkues.

3. Vlera e sipërfaqes që tjetërsohet të paguhet nga subjekti kërkues “Mane TCI” sh.p.k. para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Autorizohet Drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 237, datë 4.4.2012

**PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQES PREJ 400 M², TË
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2735, ME NR. 29/20, FSHATI MULLET,
KOMUNA PETRELË, TIRANË, QË DO TË TJETËRSOHEM NË FAVOR TË SUBJEKTIT
KËRKUES “MANE TCI” SHPK, PËR LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT
FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar dhe të pikës 4 të vendimit nr. 12, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e të drejtës së pronësisë të pasurisë së paluajtshme me nr. 29/20, në zonën kadastrale 2735, fshati Mullet, komuna Petrelë, Tiranë, me indeks harte K-34-100 (44-D), me sipërfaqe 400 (katërqind) m², të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në favor të subjektit kërkues “Mane TCI” sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqes që tjetërsohet, të përlllogaritet sipas vendimit nr. 139 datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, duke pasur parasysh edhe vlerën e kaparit, të paguar nga subjekti kërkues.



3. Vlera e sipërfaqes që tjetërsohet, të paguhet nga subjekti kërkues “Mane TCI” sh.p.k., para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Autorizohet drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 238, datë 4.4.2012

**PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQES PREJ 870 M², TË
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2735, ME NR. 29/10, FSHATI MULLET,
KOMUNA PETRELË, TIRANË, QË DO TË TJETËRSOHEM NË FAVOR TË SUBJEKTIT
KËRKUES “MANE TCI” SHPK PËR LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT
FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar dhe të pikës 4 të vendimit nr. 12, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e të drejtës së pronësisë të pasurisë së paluajtshme me nr. 29/10, në zonën kadastrale 2735, fshati Mullet, komuna Petrelë, Tiranë, me indeks harte K-34-100 (44-D), me sipërfaqe 870 (tetëqind e shtatëdhjetë) m², të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në favor të subjektit kërkues “Mane TCI” sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqes që tjetërsohet, të përlllogaritet sipas vendimit nr. 139, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, duke pasur parasysh edhe vlerën e kaparit, të paguar nga subjekti kërkues.

3. Vlera e sipërfaqes që tjetërsohet, të paguhet nga subjekti kërkues “Mane TCI” sh.p.k., para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Autorizohet drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 239, datë 4.4.2012

**PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQES PREJ 940 M², TË
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2735, ME NR. 29/19, FSHATI MULLET,
KOMUNA PETRELË, TIRANË, QË DO TË TJETËRSOHEM NË FAVOR TË SUBJEKTIT
KËRKUES “MANE TCI” SHPK PËR LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT
FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar dhe të pikës 4 të vendimit nr. 12, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e të drejtës së pronësisë të pasurisë së paluajtshme me nr. 29/19, në zonën kadastrale 2735, fshati Mullet, komuna Petrelë, Tiranë, me indeks harte K-34-100 (44-D), me sipërfaqe 940 (nëntëqind e dyzet) m², të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në favor të subjektit kërkues “Mane TCI” sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqes që tjetërsohet, të përllogaritet sipas vendimit nr. 139, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, duke pasur parasysh edhe vlerën e kaparit, të paguar nga subjekti kërkues.

3. Vlera e sipërfaqes që tjetërsohet, të paguhet nga subjekti kërkues “Mane TCI” sh.p.k., para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Autorizohet drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 240, datë 4.4.2012

**PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQES PREJ 375 M², TË
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2735, ME NR. 29/22, FSHATI MULLET,
KOMUNA PETRELË, TIRANË, QË DO TË TJETËRSOHEM NË FAVOR TË SUBJEKTIT
KËRKUES “MANE TCI” SHPK PËR LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT
FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar dhe të pikës 4 të vendimit nr. 12, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e të drejtës së pronësisë të pasurisë së paluajtshme me nr. 29/22, në zonën kadastrale 2735, fshati Mullet, komuna Petrelë, Tiranë, me indeks harte K-34-100 (44-D), me sipërfaqe 375 (treqind e shtatëdhjetë e pesë) m², të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në favor të subjektit kërkues “Mane TCI” sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqes që tjetërsohet, të përlllogaritet sipas vendimit nr. 139, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, duke pasur parasysh edhe vlerën e kaparit, të paguar nga subjekti kërkues.

3. Vlera e sipërfaqes që tjetërsohet, të paguhet nga subjekti kërkues “Mane TCI” sh.p.k., para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Autorizohet drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 241, datë 28.3.2012

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1566, DATË 26.11.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN KATUND I RI, TË QARKUT TË
DURRËSIT”, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 697, DATË 21.5.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË
PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË
QEVERISJES VENDORE, KOMUNA KATUND I RI, TË QARKUT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Katund i Ri, të qarkut të Durrësit. Lista ka 1 (një) fletë dhe mbaron me numër rendor 1.

2. Miratimin e listës shtesë të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të kësaj njësie. Lista ka 1 (një) fletë dhe mbaron me numër rendor 8.

3. Ndryshimet në listën e inventarit dhe në listën përfundimtare të pyjeve dhe kullotave, që transferohen në pronësi, si dhe lidhjen nr. 1 (një), i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Katund i Ri, e qarkut të Durrësit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 243, datë 4.4.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 431, DATË 11.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË BASHKISË GRAMSH, TË QARKUT TË ELBASANIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 8/a të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Revokimin e kalimit të së drejtës së pronësisë për bashkinë Gramsh dhe heqjen nga lista, që i bashkëlidhet vendimit nr. 431, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, përkatësisht, të pronave me numrat 26 dhe 31, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Shëndetësisë, për Drejtorinë e Shëndetit Publik, Gramsh, të pronave nr. 26 dhe nr. 31, për shërbimin shëndetësor parësor Gramsh, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Shëndetësisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 244, datë 4.4.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS
BUÇIMAS, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Buçimas të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Buçimas, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr. 788, datë 4.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Buçimas të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Buçimas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Buçimas Korçë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
15-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
21-27	Prona që përdoren për shërbim funeral	Në pronësi
28-30	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore dhe sportive	Në pronësi
31-38	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave dhe objekteve të çdo lloji	Në përdorim
154-156, 158-164, 165-181	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
182, 184, 186, 188, 190, 192, 194	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim DAMT e qarkut Korçë ka vënë në dispozicion nga kjo komunë sipërfaqen 84.4 ha në fshatin Guras për AKKP
183, 185, 187, 189, 191, 193, 195, 219, 220, 227, 235,257, 273, 274, 287, 288, 289, 290, 291, 297,301, 302, 303, 305, 315	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

URDHËR

Nr. 35, datë 23.3.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LICENCIMIT TË EKUIPAZHIT FLUTURUES, ORGANIZATAVE TË TRAJNIMIT DHE SEKSIONEVE AEROMJEKËSORE AMC DHE AME

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, në zbatim nenit 20 pika 4 të ligjit 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10 484, datë 24.11.2011” dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e licencimit të ekuipazhit fluturues, organizatave të trajnimit dhe seksioneve aeromjekësore AMC dhe AME”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe procedurave përkatëse që janë pjesë përbërëse e tij.

2. Urdhri i ministrit nr.110, datë 14.7.2008 “Për miratimin dhe zbatimin e rregullores për licencimin e personelit fluturues” shfuqizohet.

3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e rregullores së miratuar me këtë urdhër.

4. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi



RREGULLORE
PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LICENCIMIT TË EKIPIZHIT FLUTURUES,
ORGANIZATAVE TË TRAJNIMIT, QENDRAVE AEROMJEKËSORE (AMC) DHE
EKZAMINUESVE AEROMJEKËSORË (AME)

KAPITULLI I
LICENCIMI I EKIPIZHIT FLUTURUES

Neni 1
Përcaktime

Për qëllimin e kësaj rregulloreje:

“AME” nënkupton ekzaminuesin mjekësor të autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për lëshimin e certifikatës mjekësore e cila nevojitet për mbajtjen e licencës së pilotit.

“AMC” nënkupton qendrën aeromjekësore të autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për lëshimin e certifikatës mjekësore që nevojitet për të fituar apo mbajtur një licence piloti.

“AMS” nënkupton seksionin aeromjekësor të Autoritetit të Aviacionit Civil.

“ICAO Aneks X” nënkupton aneksin e I të Konventës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, nënshkruar në Çikago në 7 dhjetor të 1944.

“Koordinatori kombëtar i licencimit” nënkupton personin e emëruar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, i cili koordinon me grupin e standardizimit mjekësor dhe të licencimit.

“Licencë” nënkupton një dokument të vlefshëm të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, i cili autorizon mbajtësin të ushtrijë funksionet si pjesëtar i personelit të kabinës në bordin e një avioni civil të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

“Autoriteti licencues” nënkupton autoritetin e përcaktuar si përgjegjës për licencimin e personelit dhe konkretisht, Autoriteti i Aviacionit Civil.

“Klasifikim” nënkupton një autorizim të regjistruar në një licence ose të shoqëruar me një licencë, duke u bërë për rrjedhojë pjesë e saj në të cilin janë përcaktuar kushtet specifike, privilegjet apo kufizime që i përkasin kësaj licence.

“Pranimi i licencave” nënkupton aktin e njohjes së një licence *JAR FCL*, të lëshuar nga një shtet ish-anëtar i JAA, apo i asociuar në EASA, së bashku me privilegjet dhe certifikatat që i përkasin, sipas kufizimit kohor të vendosur në licencën origjinale.

“Konvertimi (i një licence)” nënkupton lëshimin e një licence forme *JAR-FCL*, siç përcaktohet në këtë rregullore, referuar një licence të lëshuar nga një shtet që nuk ka qenë anëtar i JAA, kur mes *RSH-së* dhe atij shteti ekziston një marrëveshje për këtë qëllim.

“Dhënia e vlefshmërisë” nënkupton aktin e kryer nga Autoriteti i Aviacionit Civil, mbështetur në vlerësimin dhe gjykimin e tij, si një alternativë për të lëshuar licencën e tij, duke vlerësuar si të vlefshme një licencë të lëshuar nga një shtet anëtar i ICAO-s, joanëtar i JAA-së, apo i asociuar në EASA, si ekuivalente të licencës së tij.

“Pilot privat” nënkupton një pilot i cili mban një licencë që ndalon pilotimin e avionëve në operime tregtare, për qëllime fitimi. “Pilot profesional” nënkupton një pilot që mban një licencë e cila lejon pilotimin e një avioni të përfshirë në operime tregtare, për qëllime fitimi.

“Kontrollet e aftësisë” nënkupton demonstrimin e aftësive për të rivlerësuar apo ripërtërirë klasifikimet, të cilat përfshijnë provimin teorik ashtu siç mund të kërkohet nga ekzaminuesi mjekësor.

“Testet e aftësisë” nënkuptojnë demonstrimin e aftësive të nevojshme për lëshimin e licencës apo që përfshin provimin teorik, ashtu siç mund të kërkohet nga ekzaminuesi.

“Certifikate mjekësore” nënkupton dokumentin certifikues të aftësisë mendore dhe fizike për fitimin apo mbajtjen e licencës së pilotit.

“Konfidencialiteti mjekësor” nënkupton kufizimin e hyrjes në informacionin mjekësor personal të mjekëve të AMS-së dhe stafit të tyre mbështetës.

“Informacioni mjekësor personal” nënkupton të dhënat dhe raportet mjekësore të paraqitura tek AMS nga mjekët ekzaminues dhe të tjerë.

“JAR-FCL 1, 2, 3” nënkupton kërkesat e përbashkëta të aviacionit në lidhje me licencimin e ekuipazhit fluturues, të cilat janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje dhe përbëjnë standardet teknike të aplikuara nga shtetet ish-anëtare të JAA-së.

“JIP (procedurat e përbashkëta të implementuara)” nënkupton materialin udhëzues dhe administrativ të JAA- seksioni V, amendamenti i bërë në tetor 2008, i cili është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Neni 2

Kushte të përgjithshme

1. Kjo rregullore ka pjesë integrale të saj:

a) Kërkesat e JAR-FCL 1, amendamenti i datës 1 dhjetor 2006, të cilat aplikohen për lëshimin edhe mbajtjen e klasifikimeve dhe licencave të avionit, rregullojnë mënyrën sesi aplikantët të fitojnë, rivlerësojnë dhe rinovojnë licencat dhe klasifikimet për avionë, si edhe programet e trajnimit, provimet, testet dhe kontrollet për licencat dhe klasifikime të tilla.

b) Kërkesat e JAR-FCL 2, amendamenti 6 i datës 1 shkurt 2007, të cilat aplikohen për lëshimin dhe mbajtjen e klasifikimeve dhe licencave të helikopterit, rregullojnë mënyrën sesi aplikantët të fitojnë, rivlerësojnë dhe rinovojnë licencat dhe klasifikimet për helikopterë, si edhe programet e trajnimit, provimet, testet dhe kontrollet për licenca dhe klasifikime të tilla.

c) Kërkesa të JAR-FCL 3, amendamenti 5 i datës 1 dhjetor 2006, të cilat kanë të bëjnë me pajisjen me certifikatë mjekësore, në mënyrë që aplikantët apo mbajtësit e licencave shqiptare të lëshuara sipas JAR-FCL 1 dhe JAR-FCL 2 të mund të ushtrojnë privilegjet e lidhura me licencat dhe klasifikimet e tyre.

d) JIP-s - Procedurat implementuese të kërkesave sipas nënpikave “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike.

a) Mbajtësi i licencës i cili ka mbushur moshën 60 vjeç nuk do të veprojë si pilot në një avion që operon si transportues ajror tregtar përveçse:

i) si një anëtar i një ekuipazhi me shumë pilotë; dhe nëse

ii) një mbajtës i kësaj licence është i vetmi pilot në ekuipazh i cili ka mbushur moshën 60-vjeçare.

b) Mbajtësi i një licence i cili ka mbushur moshën 65 vjeç nuk do të veprojë si pilot në një avion që operon si transportues ajror tregtar.

Neni 3

Pranimi i licencave JAR FCL dhe dhënia e vlefshmërisë së licencave të dhëna nga një shtet i ICAO-së, joanëtar i JAA-së apo i asociuar në EASA

1. Autoriteti i Aviacionit Civil pranon pa vonesa apo testime shtesë, çdo licencë të lëshuar nga një shtet ish-anëtar i JAA-së, apo i asociuar në EASA, bashkë me privilegjet dhe certifikatat që bëjnë pjesë në të, duke lëshuar një certifikatë pranimi. Kjo certifikatë do të tregojë shtetin e lëshimit të licencës origjinale, numrin, datën e lëshimit dhe të përfundimit të afatit të licencës JAR-FCL.

2. Një licencë piloti e lëshuar në përputhje me aneksin 1 të ICAO-së nga një shtet joanëtar i JAA-së, apo joasociuar në EASA, mund të vlerësohet si subjekt i kushteve të vendosura nga



Autoriteti i Aviacionit Civil, në mënyrë që t'i lejohej të fluturojë (me përjashtim të fluturimeve mësimore) në avionë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, sipas rregullave dhe procedurave të përmendura në JAR-FCL dhe të zhvilluara në procedurat operative të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Neni 4

Konvertimi i licencave të shteteve joanëtare të JAA-së apo të paasociuara në EASA

1. Konvertimi i një licence profesionale, që nuk është JAP-FCL, në licencë të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar, mund të bëhet në rast se ekziston një marrëveshje paraprake për këtë qëllim ndërmjet institucionit kompetent në Republikën e Shqipërisë dhe atij të shtetit tjetër, i cili duhet të jetë një shtet anëtar i ICAO-së.

2. Kjo marrëveshje me shtetin joanëtar të JAA-së ose jo të asociuar në EASA, do të përcaktojë kushtet për konvertim dhe ndryshimet ndërmjet dy sistemeve të licencimit.

3. Një licencë e konvertuar sipas kësaj marrëveshjeje do të ketë një shënim në të, i cili do të përcaktojë shtetin joanëtar të JAA-së ose jo të asociuar në EASA, mbi të cilin është mbështetur konvertimi. Privilegjet dhe kufizimet e këtij konvertimi do të jenë ato të cilat tregohen në kërkesat e JAR-FCL.

4. Në bazë të principit të reciprocitetit, të njëjtat kërkesa do të aplikohen për konvertimin në një licencë JAR FCL, deri sa Shqipërisë t'i njihet e drejta për lëshimin e licencave të saj JAR-FCL.

Neni 5

Aftësia e gjuhës angleze

1. Të gjithë mbajtësit e licencave që do të pilotojnë avionët e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, në të cilët kërkohet përdorimi i radiotelefonisë, duhet të kenë një vërtetim të aftësisë së gjuhës angleze të përfshirë në licencën e lëshuar apo së cilës i është dhënë vlefshmëria.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar nuk jep vlefshmërinë e një licence pa nivelin e gjuhës angleze së paku në nivelin 4 të vërtetuar, apo në rastin kur vërtetimi i aftësisë së gjuhës ka skaduar.

3. Aftësia e gjuhës angleze që do të kërkohet, duhet të jetë të paktën në nivelin operacional 4.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të njohë për mbajtësit e licencave të tij, çdo certifikatë të aftësisë së gjuhës angleze, të lëshuar nga një organizatë, nëse:

a) Organizata ka eksperiencë paraprake në vlerësimin e gjuhës angleze për pilotë, sipas kërkesave të ICAO-së (në këtë rast do të jetë aprovuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil);

b) Organizata ka një aprovim të veçantë nga një autoritet i një shteti tjetër ish anëtar të JAA-së, apo i asociuar në EASA;

c) Një shtet i tillë ka dorëzuar planin e implementimit apo ka bërë të njohur përmbushjen e tij të plotë me kërkesat e ICAO-së (FISX *web site*).

5. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar nuk do të njohë nivelin e aftësisë së gjuhës të vendosur në licencën e pilotit nga një shtet anëtar i ICAO-së, në rast se nuk vërtetohet përmbushja e kërkesave të ICAO-së nga shteti në fjalë apo ai shtet nuk ka notifikuar planin e implementimit tek ICAO.

Neni 6

Trajnimi i pilotëve, testimi dhe kontrolli

1. I gjithë trajnimi teorik dhe praktik do të kryhet në organizatat e aprovuara të trajnimit, sipas kërkesave JAR-FCL.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të pranojë trajnimin, testimin dhe kontrollin e kryer sipas kërkesave të JAR-FCL dhe në përputhje me to, vetëm në rast se kushtet e këtij aktiviteti janë të barabarta ose mbi minimumin e kushteve të përshkruara në këtë rregullore.

Neni 7

Ankimet dhe zbatimi

1. Autoriteti i Aviacionit Civil në çdo rast, në përputhje me rregullat në fuqi, mund të veprojë në përgjigje të ankimeve, të kufizojë privilegjet, apo të pezullojë ose të revokojë një licencë, klasifikim, miratim apo certifikatë që është lëshuar sipas kërkesave të JAR-FCL, nëse konstatohet se aplikanti apo mbajtësi i licencës nuk ka plotësuar apo plotëson kërkesat e JAR-FCL, të përfshira në këtë rregullore apo ligjin përkatës kombëtar.

2. Në rast se Autoriteti i Aviacionit Civil konstaton se aplikanti apo mbajtësi i licencës JAR-FCL të lëshuar nga një shtet anëtar tjetër i JAA-së nuk ka plotësuar apo nuk plotëson rregullat e JAR-FCL apo ligjin kombëtar përkatës të shtetit në të cilin përdoret avioni, Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të njoftojë shtetin e lëshimit të licencës.

3. Kur një aplikim për licencë ose klasifikim është refuzuar apo është dhënë në terma të tjerë nga ajo që është kërkuar, aplikanti mund të kërkojë që rasti të rishihet nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar.

4. Gjithashtu, një aplikant i cili ka dështuar në një testim apo provim, i cili i kërkohet aplikantit para se ai të marrë apo të ushtrojë privilegjet e licencës ose klasifikimit, mund të kërkojë që Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar të shqyrtojë nëse provimi apo testi janë kryer në mënyrën e duhur.

Neni 8

Forma dhe formularët e licencës dhe certifikatës mjekësore

1. Forma dhe paraqitja e licencave të fluturimit do të jenë në përputhje me JAR-FCL, si më poshtë në këtë rregullore. E njëjta paraqitje do të përdoret edhe për lëshimin e certifikatës së dhënies së vlefshmërisë, me kusht që ky informacion të përfshihet në format.

2. Të gjitha licencat, dhëniet e vlefshmërisë dhe njohjet do të lëshohen me firmën e Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit në përputhje me Kodin Ajror. Klasifikimet do të lëshohen, rivlerësohen dhe rinjihen me firmën e Drejtorit të Sigurisë Ajrore.

3. Forma dhe paraqitja e certifikatës mjekësore do të jetë në përputhje me JAR-FCL 3, si më poshtë në këtë rregullore. Për qëllim të lëshimit, rinjohjes apo rivlerësimit të një certifikate mjekësore, do të përdoren formularët që përmban JIP JAA AGM seksioni 5, si më poshtë në këtë rregullore.

4. Në të gjitha licencat apo certifikatat mjekësore, në varësi të dokumentit, do të vendoset referenca "Form FCL...".

KAPITULLI II

PROCEDURAT PËR APROVIMIN E KURSEVE TË TRAJNIMIT DHE ORGANIZATAVE TË JAR-FCL

Neni 9

Trajnimi praktik dhe teorik

1. Trajnimi teorik dhe praktik për lëshimin, rivlerësimin dhe rinjohjen e licencave, klasifikimeve dhe autorizimeve do të jepen nga qendrat e regjistruara, organizatat e trajnimit të



fluturimit dhe organizatat e trajnimit të klasifikimit sipas tipit, të cilat janë të regjistruara apo të miratuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar ose nga një shtet ish-anëtar i JAA-së, sipas kërkesave dhe programeve të trajnimit të aprovuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar, me kusht që trajnimi të jetë i njëjtë ose mbi nivelin minimal të kushteve të përshkruara në këtë rregullore.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të japë miratimin dhe regjistrimin e qendrave dhe të organizatave trajnuese vetëm pas vlerësimit të përputhshmërisë së tyre me rregullat e JAR-FCL pjesë të kësaj rregulloreje.

3. Aprovimi i organizatave dhe kurseve të trajnimit do të jepet nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar pas plotësimit të aplikimit të veçantë dhe pas inspektimeve të duhura. Rivlerësimi i miratimit mund të jepet nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar pas inspektimeve të duhura.

4. Inspektimet do të bëhen vetëm pasi Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar të jetë dakord se aplikimi i bërë do të jetë i pranueshëm.

5. Nëse një organizatë trajnimi bën marrëveshje me organizata trajnimi të tjera ose përdor baza aerodromesh alternative si pjesë e organizimit të trajnimit të përgjithshëm, këto organizata të tjera do të veprojnë konform kërkesave përkatëse të JAR-FCL nën përgjegjësinë e organizatave të tjera dhe do të jenë të disponueshme për inspektim.

Neni 10

Organizatat e trajnimit për fluturime (FTO)

1. Një organizatë trajnimi për fluturim është një organizatë e pajisur dhe e organizuar që operon në një ambient të përshtatshëm duke ofruar trajnime fluturimi dhe/apo instruksione fluturimi simuluese dhe/apo instruksione njohurie teorike për programe trajnimi të veçanta.

2. Kur FTO është vendosur jashtë territorit shqiptar, atëherë duhet të vërtetohet përputhshmëria e miratimit përkatës me kërkesat e kësaj rregulloreje.

3. Kur menaxhimi kryesor i FTO-së është vendosur në Shqipëri dhe ambientet e trajnimit janë si brenda dhe jashtë territorit shqiptar, dhe funksionojnë nën drejtimin e kreut të trajnimit, atëherë aplikimi për miratim do të bëhet direkt në Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar.

Neni 11

Organizata e trajnimit të klasifikimit sipas tipit (TRTO)

Një organizatë trajnimi të klasifikimit sipas tipit është një organizatë e pajisur dhe e organizuar që operon në një ambient të përshtatshëm duke ofruar trajnime të klasifikimit të tipit dhe/apo trajnime të bashkëpunimit të ekuipazhit (MCC- *training*) dhe/apo instruksione fluturimi sintetike dhe në rast se aplikohet, instruksione teorike për programues të trajnimeve të veçanta.

Një TRTO miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil sipas kërkesave që përmban kjo rregullore.

Neni 12

Qendrat e regjistruara

1. Një qendër e regjistruar është një qendër që siguron trajnime teorike dhe praktike për lëshimin e licencës të pilotëve privatë dhe klasifikimeve që lidhen me to.

2. Një qendër e regjistruar mund të miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, për të dhënë përveç kurseve të trajnimit për pilotë privatë, edhe kurse trajnimi për pilotët e *glider-ave*, balonave dhe për pilotët të specifikuar (navigator) të kategorive të veçanta, ashtu edhe për klasifikimet përkatëse.

KAPITULLI III
KËRKESAT MJEKËSORE DHE
PROCEDUARAT E IMPLEMENTIMIT TE JAR-FCL-3

Neni 13

Kërkesat mjekësore

1. Në mënyrë që të aplikohet për një licencë apo të ushtrohen privilegjet e një licence që është pranuar për dhënie vlefshmërie nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar, aplikanti apo mbajtësi i licencës duhet të ketë një certifikatë mjekësore të lëshuar në përputhje me kërkesat e JAR-FCL-3 si më poshtë, të përshtatshme me privilegjet e licencës dhe duhet jetë i aftë mendërisht dhe fizikisht për të ushtruar në mënyrë të sigurt privilegjet e licencës së aplikueshme.

2. Janë 2 klasa të certifikatës mjekësore JAR:

a) JAR klasa 1 për licenca piloti profesionale;

b) JAR klasa 2 për licenca piloti privat. Ekzaminimi fillestar i JAR-FCL klasit të parë kryhet në qendrën aeromjekësore në Tiranë.

3. Me aplikimin e mbajtësit të certifikatës mjekësore të JAR FCL të klasit të parë të lëshuar në një shtet tjetër, Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të njohë këtë certifikatë mjekësore pa testime të mëtejshme.

Neni 14

Seksioni aeromjekësor (AMS)

1. Në përputhje me rregullat JAR FCL 3, si më poshtë, një nga ekzaminuesit aeromjekësor të aprovuar, do të autorizohet të veprojë në emër të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar, si (AMS) seksion aeromjekësor.

2. Konfidencialiteti mjekësor do të respektohet në çdo kohë. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të sigurojë se të gjitha raportet me shkrim apo me gojë dhe informacioni i ruajtur elektronikisht për çështjet mjekësore, të mbajtësit apo aplikuesit të licencës, do të vihen në dispozicion të (AMS) seksionit aeromjekësor, (AMC) qendrës aeromjekësore dhe ekzaminuesit aeromjekësor që trajtojnë aplikimin për qëllim të plotësimit të një vlerësimi mjekësor.

3. Aplikanti apo mjeku i tij do të kenë akses tek i gjithë dokumentacioni në përputhje me ligjin kombëtar.

Neni 15

Qendrat aeromjekësore (AMC)

1. Qendrat aeromjekësore do të përcaktohen dhe autorizohen, dhe/ose riautorizohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar për një periudhë jo më tepër se 3 vjet.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të vendosë numrin e qendrave aeromjekësore që i nevojiten duke marrë parasysh numrin e vlerësimeve që kryen.

Neni 16

Ekzaminuesit mjekësorë të autorizuar (AME-të)

1. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të përcaktojë dhe autorizojë AME-të. Ekzaminuesit mjekësorë të autorizuar, brenda kufijve të saj, të kualifikuar dhe të licencuar në degën e mjekësisë dhe të trajnuar në mjekësinë e aviacionit në përputhje me JAR-FCL 3. Një ekzaminues mjekësor do të jetë i autorizuar për një periudhë jo më shumë se 3 vjet.



2. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të vendosë numrin e ekzaminuesve që i nevojiten, duke marrë parasysh numrin dhe shpërndarjen gjeografike të pilotëve të tij.

Neni 17

Seksioni aeromjekësor (AMS) dhe konfidencialiteti mjekësor

1. Konfidencialiteti mjekësor duhet të respektohet në çdo kohë.
2. AMS- seksioni aeromjekësor ka përgjegjësi vetëm brenda Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar në lidhje me çështjet mjekësore. Staf i punësuar për të mbështetur AMS, do të jetë i autorizuar nga AMS për të hyrë në informacionet personale mjekësore.
3. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të sigurojë se të gjitha raportet të shkruara ose jo dhe informacioni i ruajtur elektronikisht në çështjet mjekësore të mbajtësve/aplikantëve janë në dispozicion të AMC-së, AME-së dhe AMS-së që merren me aplikimin dhe për qëllim të plotësimit të vlerësimit mjekësor. Aplikanti dhe mjeku i tij do të kenë akses tek i gjithë dokumentacioni në përputhje me ligjin kombëtar.
4. Masa të përshtatshme sigurie do të vendosen për të siguruar se vetëm personeli i autorizuar do të ketë akses në të dhënat mjekësore kur është e justifikueshme nga kushte të veçanta. AMS mundet që pjesë të caktuara të raportit mjekësor t'i bëjë të disponueshme për zyrtarë të tjerë, në përputhje me ligjin kombëtar.
5. Të dhënat mjekësore mund të ruhen aq gjatë sa është e nevojshme në përputhje me ligjin kombëtar. Një sistem i koduar sigurie duhet të aktivizohet për të siguruar dokumentet e transmetuara dhe të ruajtura elektronikisht.

Neni 18

Procedura për përjashtimet mjekësore

1. Përjashtimet mjekësore që konsistojnë në përjashtime nga neni 17 i kësaj rregulloreje, miratohen nga drejtori ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar, me propozim të AMS-së, vetëm në rastin kur përjashtimet nuk cenojnë nivelin e sigurisë.
2. Përjashtimet mjekësore do të jepen sipas procedurave të seksionit II të JAR-FCL.

Neni 19

Procedurat e rishikimit mjekësor

1. Nëse një aplikant nuk përmbush kushtet e JAR-FCL 3, nënpjesës B dhe C, mund t'i kërkohet një rishikim nga seksioni aeromjekësor sipas shtojcave të këtyre nënpjesëve.
2. Nëse aplikantit i është dhënë një certifikatë mjekësore pas një procedure rishikimi nga AMS, çdo kufizim që mund të kërkohet do të shënohet në certifikatën mjekësore sipas seksionit V të JIP JAA AGM.
3. Ky shënim do t'i lejojë që çdo (AME) ekzaminues mjekësor i autorizuar të jetë në dijeni të rishikimit të mëparshëm të AMS, në rast se kushtet apo instruksionet e veçanta aplikohen dhe të kontaktojë AMS për më tepër informacione kur është e nevojshme.
4. AMS mund të vlerësojë si të përshtatshëm aplikantët që nuk plotësojnë kërkesat e JAR-FCL 3 nënpjesa B ose C, por që janë në përputhje me kërkesat e shtojcave.
5. Nëse aplikantit i është dhënë apo i është refuzuar një certifikatë mjekësore pas një procedure rishikimi, aplikanti, AME ose AMC do të njoftohet nga AMS në lidhje me vendimin final me shkrim.
6. Është në diskrecion të AMS-së, që vlerësimet e përshtatshmërisë të mund t'ia delegojë AMC-së ose AME-së. Në rast të vlerësimeve të përshtatshmërisë, AMS do të informohet për detajet

e këtij vlerësimi. Për më tepër, AMS mund të revokojë një vlerësim të tillë, nëse vihet re që nuk përputhet me kërkesat e JAR FCL 3 ose me ligjin përkatës kombëtar.

Neni 20

Rishikimi i dytë për vlerësimin mjekësor

Një procedurë për rivlerësimin e dytë do të caktohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar me këshillues të pavarur mjekësor, me eksperiencë në fushën e mjekësisë së aviacionit për të vlerësuar dhe konsideruar rastet e diskutueshme

KAPITULLI IV

TRAJNIMI DHE KUALIFIKIMI I INSPEKTORËVE TË FCL-së

Neni 21

Trajnimi i inspektorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil

1. Të gjithë inspektorët duhet të trajnohen, kualifikohen dhe duhet të kenë eksperiencën e nevojshme në varësi të rolit dhe përgjegjësisë që ata kanë.

2. Në varësi të rolit dhe përgjegjësisë, trajnimi për inspektorët do të përfshijë, por nuk kufizohet në:

- i) kërkesat kombëtare që lidhen me detyrat e tyre të inspektimit;
- ii) konventën e Çikagos dhe anekset përkatëse në varësi të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre;
- iii) JAR FCL, JAR-et e tjera dhe JIP-et (procedurat e përbashkëta të implementimit) që lidhen me to;
- iv) sistemin e cilësisë që lidhet me JAR-FCL.

KAPITULLI V

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 22

Zbatimi

Kërkesat e JAR-FCL 2, të cilat aplikohen për lëshimin dhe mbajtjen e klasifikimeve dhe licencave të helikopterit, të fillojnë të zbatohen në gjashtëmuorin e dytë, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Mbikëqyrja

Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje nga të gjithë operatorët ajrorë që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

URDHËR

Nr. 83/1, datë 6.3.2012

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, nenit 6, germa “b” e ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit znj.Ruko Malko Sako, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, pasi ka mbushur moshën 65 vjeç.
2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit, të përbërë nga 5 anëtarë:
 - a) Znj.Diana Toro, Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira;
 - b) Znj.Rezarta Koçi, inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira;
 - c) Z.Erjon Ndreca, inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira;
 - d) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë;
 - e) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.
3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Tiranë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.
4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Ruko Sako nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.
5. Urdhri t'i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.
6. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

VENDIM Nr.22, datë 23.4.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Fatmir Hoxha	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Altina Xhoxha	Anëtare e “ “
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datë 27.3.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 6 Akti, që i përket:

KËRKUES: Bledar Balliu, përfaqësuar nga avokat Kastriot Brahim Muco, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.174, datë 11.7.2008, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe i vendimit nr.00-2010-666 (515), datë 21.5.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1/2, 131/f, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe diskutoi atë në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendim nr.77, datë 19.3.2007, ka vendosur deklarimin e pafajshëm të kërkuesit, të akuzuar për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.174, datë 11.7.2008, në lidhje me kërkuesin, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke e deklaruar atë fajtor për kryerjen e veprës penale të vjedhjes në bashkëpunim dhe në bazë të neneve 134 e 51 të KP-së e ka dënuar me 18 muaj burgim.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr.00-2010-666 (515), datë 21.5.2010, bazuar në nenin 433 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka vendosur mospranimin e rekursit, për arsye se ai nuk përmban nënshkrimin e mbrojtësit, sipas nenit 435/2 të KPP-së.

II

Pretendimet e palëve, parashtruar Gjykatës Kushtetuese

4. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt shqyrtimi si dhe duke pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duke vendosur, në Dhomë Këshillimi, mospranimin e rekursit të kërkuesit për shkak se nuk përmban nënshkrimin e mbrojtësit, i ka mohuar atij të drejtën kushtetuese të aksesit në gjykatë, pra të drejtën për gjykim, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

Në lidhje me pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë

5. Kërkuesi pretendon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit për arsye se nuk përmbante nënshkrimin e mbrojtësit, i ka cenuar të drejtën për t'iu drejtuar asaj gjykate dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura prej tij në rekurs.

6. Gjykata i vlerëson pretendimet e kërkuesit në kuptim të standardeve që përkufizojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Ajo është shprehur, në jurisprudencën e saj, se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (shih vendimet e



Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.6.2009; nr.38, datë 30.12.2010; nr. 8, datë 16.03.2011; nr.10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011, nr. 41, datë 28.9.2011).

7. Gjykata ka theksuar gjithashtu se e drejta për t'iu drejtuar një gjykatë nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimin të një apelimi), por këto kufizime nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e të drejtës. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.06.2010; nr.38, datë 30.12.2010; nr.8, datë 16.3.2011, nr. 41, datë 28.9.2011).

8. Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), Gjykata ka mbajtur qëndrimin se mospranimi i një kërkesë në Gjykatën e Lartë nuk duhet të cenojë thelbin e të drejtës së ankimesit për t'iu drejtuar gjykatës, pasi kjo e drejtë është thelbësore në një shoqëri demokratike, për shkak të pasojave që ka mbi interesat legjitime të individit (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 28.9.2011).

9. Në vijim të garancive të ofruara nga Kushtetuta, neni 31/ç i saj parashikon se gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme; ndërsa neni 43 i Kushtetutës parashikon: "Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe."

10. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural, të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale (KPP), nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Shqyrtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 24.7. 2006, nr. 41, datë 28.9.2011).

11. Gjykimi në Gjykatën e Lartë, në dallim nga procedurat e gjykimit që zhvillohen në gjykatat e tjera të zakonshme, ka si veçori paraqitjen vetëm të argumenteve ligjore. Kompleksiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë, konfirmohet edhe nga dispozitat ligjore që sanksionojnë se palët duhet të përfaqësohen në këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi nga Gjykata e Lartë kryesisht i çështjeve të ligjit, jo vetëm që e justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancat dëgjimore, por për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 4.3.2008; nr. 10, datë 29.3.2011, nr. 41, datë 28.9.2011).

12. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim, sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale, për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikon procedura penale (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.38, datë 30.12.2010; nr. 10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011, nr. 41, datë 28.9.2011).

13. Gjykata ka vlerësuar se neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon *inter alia* se akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit, me pasojë mospranimin, nuk mund të interpretohet nga Gjykata e Lartë në një mënyrë të tillë që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykatë. Neni 435/2 i KPP-së ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së, për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që disiplinonin paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 të KPP-së), si dhe ato të veçanta

për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP-së). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011, nr. 41, datë 28.9.2011).

14. Në këtë vështrim, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 5, datë 15.9.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së, duke u shprehur se “Sekretaritë e gjykatave, ku depozitohet ankimi, mund dhe duhet të vënë në dijeni të pandehurit në rastet kur rekursi paraqitet i panënshkruar nga mbrojtësi, me qëllim që, në zbatim të kërkesave të nenit 415/2 të KPP-së, ai të ketë mundësinë për plotësimin e tij”. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t’iu drejtuar Gjykatës së Lartë (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011, nr. 41, datë 28.9.2011).

15. Gjykata ka theksuar se çdo interpretim i ndryshëm, që mund t’i bëhet përmbajtjes së nenit 435/2 të KPP-së, nuk i shërben garantimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës. Referimi i bërë nga Kolegji Penal vetëm në kërkesat e nenit 435/2 të KPP-së, duke mos marrë në konsideratë kërkesat e nenit 432 të KPP-së për shqyrtimin e rekursit, cenon të drejtën e individit për t’iu drejtuar Gjykatës së Lartë (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 16.3.2011, nr. 41, datë 28.09.2011).

16. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi Bledar Balliu ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs i cili nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi i tij. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, sipas kërkesave të nenit 435/2 të KPP-së.

17. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se, në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka interpretuar nenin 435/2 të KPP-së në mënyrë të ngushtë dhe të shkëputur nga fryma e Kushtetutës dhe fjalia vijuese e kësaj dispozite procedurale. Nga materialet e paraqitura para Gjykatës Kushtetuese nuk rezulton që Kolegji Penal të ketë vlerësuar veprimet e sekretarisë gjyqësore përkatëse për vënien në dijeni të kërkuesit për mosplotësimin e kërkesës formale të nënshkrimit të rekursit nga mbrojtësi, në mënyrë që ai të mund të bënte plotësimet e nevojshme.

18. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, si një nga standardet për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

19. Gjykata vëren se kërkuesi në objektin e kërkesës së tij pretendon edhe shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, por nuk ngre pretendime në lidhje me këtë vendim, për pasojë Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit nuk është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,



VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2010-666 (515), datë 21.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi) dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në këtë gjykatë.
- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza.

VENDIM
Nr.23, datë 23.4.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datë 20.4.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 11 Akti, që i përket:

KËRKUES: Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar me autorizim nga prokurori z.Kujtim Luli.

SUBJEKT I INTERESUAR: Leonard Luzi, në mungesë.

OBJEKTI: Interpretimi i vendimit nr.4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me kërkues Leonard Luzi.

BAZA LIGJORE: Nenet 28, 29 dhe 80 të Ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vladimir Kristo dhe përfaqësuesin e kërkuesit, Prokurorit të Përgjithshëm, që u shpreh për pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Leonard Luzi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

2. Gjykata Kushtetuese, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së Leonard Luzit, me vendim nr.4, datë 10.2.2012, ka vendosur shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.72, datë 4.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; vendimit nr.14, datë 15.2.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë; vendimit nr.00-2010-1356 (971), datë 8.11.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

3. Gjatë rigjykimit të çështjes në ngarkim të të pandehurit Leonard Luzi, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, prokurori ka evidentuar se dispozitivi i vendimit nr.4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese nuk është i qartë dhe nuk përputhet plotësisht me pjesën arsyetuese të tij, arsye për të cilën ka kërkuar shtyrjen e gjykimit me qëllim që të mundësohej Prokurori i Përgjithshëm për të paraqitur pranë Gjykatës Kushtetuese, kërkesën për interpretim të vendimit të lartpërmendur.

4. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka pranuar kërkesën e prokurorit.

5. Me shkresë nr. 190/1, datë 8.3.2012, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda i ka dërguar Prokurorisë së Përgjithshme relacionin përkatës për të iniciuar kërkesën për interpretim të vendimit nr.4, datë 10.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

II

Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese

6. Kërkuesi, Prokurori i Përgjithshëm, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar interpretimin e vendimit nr.4, datë 10.2.2012, duke parashtruar se:

6.1. Dispozitivi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë 10.2.2012, është i paqartë sepse nuk përputhet plotësisht me pjesën arsyetuese të tij.

6.2. Në arsyetimin e vendimit, objekt interpretimi, janë pranuar shkelje të standardeve të procesit të rregullt ligjor vetëm për kërkuesin Leonard Luzi, ndërsa dispozitivi i këtij vendimi krijon përshtypjen se Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar tërësisht vendimet nr.72, datë 4.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; nr.14, datë 15.2.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe nr.00-2010-1356 (971), datë 8.11.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi) si për kërkuesin Leonard Luzi, ashtu edhe për të gjykuarit e tjerë Pajtim Hysllari, Idriz Derxho, Jetmir Madani dhe Oljan Muçollari.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

7. Gjykata, në jurisprudencën e saj, në lidhje me legjitimitimin e kërkuesit, në kushtet kur ajo investohet për interpretimin e një vendimi të saj, ka theksuar se në kuptim të nenit 80 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, edhe pse Gjykata Kushtetuese ka në kompetencë të interpretojë vendimin e saj në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, por pa ndryshuar përmbajtjen e tij, ajo mund të vihet në lëvizje vetëm nga palët pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes (shih vendimin nr. 166, datë 20.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

8. Për sa më sipër, duke qenë se Prokuroria e Përgjithshme ka qenë palë e gjykimit të çështjes me kërkues Leonard Luzi, të përfunduar me vendimin nr.4, datë 10.10.2012, objekt interpretimi, Gjykata çmon se kërkuesi plotëson kushtet për legjitimitimin *ratione personae*.

Lidhur me themelin e pretendimeve

9. Sipas nenit 80 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe jurisprudencës së Gjykatës, kjo e fundit ka në kompetencë të interpretojë vendimin e saj në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, por pa ndryshuar përmbajtjen (shih vendimin nr. 6, datë 5.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese).



10. Gjykata, me vendim nr.4, datë 10.0.2012 ka vendosur shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.72, datë 4.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; vendimit nr.14, datë 15.2.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë; vendimit nr.00-2010-1356 (971), datë 8.11.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

11. Gjykata vëren se në pjesën arsyetuese të vendimit nr.4, datë 10.02.2012, është pranuar se në kuadrin e gjykimit të çështjes për një proces të rregullt ligjor, e drejta e mbrojtjes ndaj veprës së re penale, për më tepër më të rëndë dhe në disfavor të tij, në këtë proces i është mohuar të gjykuarit Leonard Luzi, duke përjashtuar të gjykuarit e tjerë. Ky fakt, që përbën thelbin e gjykimit të çështjes, trajtohet kuptueshëm në gjithë pjesën arsyetuese të vendimit. I paqartë paraqitet dispozitivi i vendimit, sepse nga formulimi i tij krijohet dyshimi që të jenë shfuqizuar tërësisht vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, me efekte edhe për të gjykuarit Pajtim Hysllari, Idriz Derxho, Jetmir Madani dhe Oljan Muçollari.

12. Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata, duke konsideruar se vendimi në tërësinë e tij duhet konsideruar si një unitet në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre, çmon se dispozitivi i vendimit nr.4, datë 10.02.2012 duhet interpretuar në pajtim dhe harmoni me pjesën arsyetuese të këtij vendimi, në të cilin janë pranuar shkelje të standardeve të gjykimit për një proces të rregullt ligjor vetëm për të gjykuarin Leonard Luzi.

13. Si rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se dispozitivi i vendimit nr.4, datë 10.2.2012 që shfuqizon, si të papajtueshëm me Kushtetutën, vendimin nr.72, datë 4.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; vendimin nr.14, datë 15.2.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe vendimin nr.00-2010-1356 (971), datë 8.11.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), ka efekt vetëm për të gjykuarin Leonard Luzi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë 10.2.2012, që shfuqizon, si të papajtueshëm me Kushtetutën, vendimin nr.72, datë 4.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; vendimin nr.14, datë 15.2.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe vendimin nr.00-2010-1356 (971), datë 8.11.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), interpretohet se ka efekt vetëm për të gjykuarin Leonard Luzi.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi,
Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Admir Thanza.

**KËRKESË
PËR SHPRONËSIM PUBLIK
Nr. 2153/5, datë 18.4.2012**

Në mbështetje të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit: tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore” që preken nga ndërtimi i linjës 110 kv Tirana 2-nënstacioni 110 kv Kashar-Selitë.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi, kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore, kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë komisionit të posaçëm të shpronësimit.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS
ELEKTRIKE 110 KV “KASHAR TIRANA 2 - NËNSTACIONI 110 KV KASHAR – SELITË”**

LISTA E PRONARËVE (sipas nr. të pasurive për sip.shtyllë)									
Fshati, Verteks	Nr i shtyllës	Emri, atësia, mbiemri	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. shtyllë	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë	Shënime për pronësinë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Kashar									
V1	1	Reshat Sorra Ramiz Sorra	2105	119/2,119/3	are	95	415	39425	pronësi pa certifikatë
V1A	2	Agim Dema	2105	33/6	are	111	415	46065	pronësi me certifikatë
V3	8	Jemin Xhaferi	2105	330/18, 330/19	are	45	415	18675	pronësi
	10	Ismail Aluku	2105	568/3	are	30	415	12450	pronësi
	11	pretendues	3865	552	are	30	415	12450	s'ka informacion
	12	pretendues	3865	558/2, 794	are	45	415	18675	s'ka informacion
	13	Ramazan Xhaferri Sali Xhaferi	3865	557/1, 557/2	are	45	415	18675	pronësi
Mezez V4	14	Pretendues	3865	562/2	are	60	415	24900	s'ka informacion
	15	Pretendues	3865	368/13/1	are	45	415	18675	s'ka informacion
	16	Pretendues	3865	116/9, 116/2, 504/1	are	45	415	18675	s'ka informacion
	17	Pretendues	3865	127/1	are	45	415	18675	s'ka informacion
Yrshek	18	Pretendues	3865	123/8	are	45	415	18675	s'ka informacion
	19	Pretendues	3865	123/27	are	45	415	18675	s'ka informacion
	20	Pretendues	3865	198/29	are	45	415	18675	s'ka informacion
	21	Pretendues	3865	261,642	are	35	415	14525	s'ka informacion
V5	22	Pretendues	3865	304/9/1,304/9	are	40	415	16600	s'ka informacion
	23	Pretendues	3865	302/12	are	95	415	39425	s'ka informacion
				Shuma totale		901		373915	

Sipërfaqe shpronësimet për bazamentet e shtyllave 901 m², vlera në lekë e shpronësimit 373915.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 8.5.2012
Doli nga shtypi më 9.5.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 38 lekë